



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 92/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve gjatë procesit zgjedhor, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se vëzhguesja e subjektit politik të PDK-së, Adelina Orana, me numër të bexhit 109, me datën 29.04.2012, rreth orës 12:09, në fshatin Surqinë në Qendrën e Votimit 2524d/03D, ka ndikuar në votues duke ju thënë që të votojnë për subjektin politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009, neni 7 paragrafi 1 pika b, f dhe g, dhe e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, neni 6 paragrafi 1 pika a dhe b, si dhe Kodit Penal Neni 177 *Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve.*

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë provë.

**Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme (LZP), parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

**Neni 118.4** *Mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar...*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**Ankesa është e pabazuar.**

Nga ankesa e parashtruar në PZAP, nuk mund të konstatohen pretendimet ankimore ngase parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi, për tu bindur se vëzhguesja e subjektit politik PDK, ka shkaktuar parregullsi gjatë procesit zgjedhor, andaj PZAP-i konstatoi se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 92/2012 më datën 30.04.2012.

**Kryesuesi i panelit**

**Ymer Hoxha**

